

**LIGJ**  
**Nr. 27/2024**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9154, DATË 6.11.2003,**  
**“PËR ARKIVAT”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

**Neni 1**

Në nenin 9 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Rrjeti arkivor i Republikës së Shqipërisë përbëhet nga:

a) Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave;

b) arkivat e përhershëm, ku bëjnë pjesë:

i. Arkivi Qendror Shtetëror;

ii. arkivat shtetërorë të tipologjisë;

iii. arkivat shtetërorë të sistemit;

iv. arkivi i Kuvendit;

v. Arkivi Historik dhe Diplomatik i Republikës së Shqipërisë;

vi. arkivat shtetërorë vendorë;

c) arkivat në veprim, ku bëjnë pjesë:

i. arkivat qendrorë në veprim;

ii. arkivat në veprim të institucioneve shtetërore.

ç) arkivat privatë.”.

2. Pika 3 shfuqizohet.

**Neni 2**

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

**“Neni 10**

1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave është organi më i lartë i rrjetit arkivor kombëtar.

2. Ajo është person juridik publik, buxhetor në varësi të Kryeministrit, me seli në Tiranë, si dhe ka vulën e stemën e saj.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave financohet nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera të ligjshme.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave drejtohet nga drejtori i përgjithshëm.”.

**Neni 3**

Në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 11, pas togfjalëshit “përpara Këshillit të Ministrave” shtohen fjalët “dhe Kryeministrit”.

**Neni 4**

Neni 12 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 12

Marrëdhëniet e punës së drejtorit të përgjithshëm, drejtuesve të tjerë, specialistëve dhe arkivistëve në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave rregullohen në bazë të legjislacionit për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.”.

Neni 5

Neni 13 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 13

1. Pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave janë Arkivi Qendror Shtetëror, arkivat shtetërorë vendorë dhe arkivat e sistemit.

Arkivat e tjerë të përhershëm dhe në veprim janë pjesë apo në varësi të institucionit/sistemit ministror që i krijon.

2. Arkivat e tjerë, që bëjnë pjesë në rrjetin arkivor të Republikës së Shqipërisë, kanë varësi metodologjike-profesionale nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.”.

Neni 6

Në nenin 17 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në fjalinë hyrëse të nenit togfjalëshi “dhe shërben” hiqet.

2. Shkronjat “b”, “c”, “ç” dhe “d”, ndryshohen si më poshtë:

“b) dokumentet që janë krijuar nga autoritetet publike deri në vitin 1944;

c) dokumentet që janë krijuar nga organet partiake deri në vitin 1991;

ç) dokumentet që janë krijuar nga autoritetet qendrore publike pa kufizim kohor, me përjashtim të atyre që ruhen në arkivat e sistemit, në arkivat e tjerë të përhershëm;

d) dokumentet e krijuara nga autoritetet e tjera publike joqendrore pas vitit 1944, por janë të vetme në llojin e tyre;”.

3. Pas shkronjës “dh” shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:

“e) dokumentet që janë të dhuruara nga personat fizikë dhe juridikë privatë dhe që vlerësohen si dokumente me rëndësi historike kombëtare nga Komisioni i Përhershëm i Ekspertëve.”.

Neni 7

Neni 19 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 19

1. Arkivat e tipologjisë janë Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit, Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit dhe Arkivi Qendror Shtetëror i Drejtësisë.

2. Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit ruan, përpunon, administron dhe shërben dokumentet në figurë, në zë dhe në lëvizje.

3. Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit ruan, përpunon administron dhe shërben të gjitha dokumentet teknike të prodhuara nga autoritetet publike në Republikën e Shqipërisë, sipas afateve të përcaktuara në këtë ligj, si edhe dokumente teknike të dhuruara.

4. Arkivi Qendror Shtetëror i Drejtësisë ruan, përpunon, administron dhe shërben të gjitha dokumentet gjyqësore dhe hetimore-penale të krijuara të të gjitha shkallëve të sistemit të drejtësisë, si dhe

dokumentet në funksion të vendimmarrjes së procesit të rivlerësimit të kryer nga organet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

5. Këta arkiva japin ndihmë metodologjike profesionale në arkivat në veprim për dokumente të tipologjisë përkatëse.”.

#### Neni 8

Neni 20 ndryshohet si më poshtë:

#### “Neni 20

1. Institucioni i Kuvendit i administron dokumentet përkatëse në arkiva që funksionojnë në mënyrë të përhershme pranë tyre.

2. Arkivat shtetërorë të sistemit janë Arkivi i Punëve të Brendshme, Arkivi i Forcave të Armatosura.

3. Arkivi i Punëve të Brendshme ruan dhe administron të gjitha dokumentet e krijuara nga institucionet në varësi të ministrisë përgjegjëse për punët e brendshme, sigurinë dhe rendin publik pas vitit 1944, me përjashtim të atyre që u përkasin arkivave të tipologjisë, pas dorëzimit të tyre sipas përcaktimeve të këtij ligji.

4. Arkivi i Forcave të Armatosura ruan dhe administron të gjitha dokumentet e krijuara nga institucionet në varësi të ministrisë përgjegjëse për Forcat e Armatosura pas vitit 1944, me përjashtim të atyre që u përkasin arkivave të tipologjisë, pas dorëzimit të tyre sipas përcaktimeve të këtij ligji.”.

#### Neni 9

Neni 21 ndryshohet si më poshtë:

#### “Neni 21

1. Arkivi Historik dhe Diplomatik është pjesë e sistemit të ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme. Ai përpunon, ruan, administron dhe shërben:

a) dokumentet e krijuara nga ministria përgjegjëse për punët e jashtme dhe institucionet në varësi të saj;

b) dokumentet e krijuara nga institucionet e tjera përgjegjëse për çështjet e jashtme dhe diasporës, kur nuk janë pjesë e kësaj ministrie.

2. Institucionet e përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 1 të këtij neni caktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për punët e jashtme dhe të drejtorit të përgjithshëm të Arkivave.”.

#### Neni 10

Neni 22 ndryshohet si më poshtë:

#### “Neni 22

Arkivat shtetërorë vendorë ruajnë dhe administrojnë dokumentet e institucioneve shtetërore vendorë, që veprojnë brenda njësisë administrativo-territoriale përkatëse, me përjashtim të atyre që ruhen nga arkivat e sistemit dhe arkivat e tipologjisë dhe që:

a) janë krijuar nga organet e pushtetit vendor pas vitit 1944;

b) janë krijuar nga institucionet vendorë të autoriteteve publike pas vitit 1944;

c) janë ruajtur në arkivat vendorë prej datës 29.6.1993, pavarësisht formës së krijimit.”.

#### Neni 11

Në pikën 1, të nenit 23, fjalët “dhe varen drejtpërdrejt nga drejtuesi i institucionit” hiqen.

## Neni 12

Neni 24 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 24

1. Arkivat qendrorë në veprim janë arkivat e ngritur në varësinë e një autoriteti qendror publik, të cilët ruajnë, përpunojnë, administrojnë dhe shërbejnë dokumentacionin e një tipologjie të veçantë, të përcaktuar në shkronjat “b” dhe “c”, të nenit 43 të këtij ligji, deri në përmbushjen e afatit të përcaktuar për dorëzimin në arkivin e përhershëm.

2. Arkivat në veprim janë njësi strukturore ose nënstrukturore të autoriteteve publike, të cilët dorëzojnë në arkivin qendror në veprim përkatës dokumentet e tipologjisë, jo më vonë se 5 vjet nga data e mbylljes së dokumentit përkatës.

3. Krijimi, rregullat e funksionimit dhe organizimit të arkivave qendrorë në veprim, si dhe afatet specifike për dorëzimin e dokumenteve të tyre pranë arkivave të përhershëm përkatës, sipas pikës 1, të nenit 43 të këtij ligji, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

## Neni 13

Neni 36 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 36

1. Përshkrimi ligjor i dokumentit elektronik bëhet sipas legjislacionit për dokumentin elektronik.

2. Rregullat për hartimin, evidencimin, qarkullimin, përpunimin tekniko-shkencor, ekspertizën e vlerës së ruajtjes e asgjësimin, si dhe për ruajtjen, dublikimin, riprodhimin, shërbimin dhe legalizimin e dokumenteve elektronike miratohen nga Këshilli i Ministrave.”

## Neni 14

Nenet 37 dhe 38 shfuqizohen.

## Neni 15

Neni 40 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 40

1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave ngre, administron dhe mirëmban, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, sistemin e arkivit të përqendruar digjital.

2. Ky sistem lidhet me të gjitha sistemet e tjera që prodhojnë dokumentacionin me nënshkrim elektronik apo/dhe vulë digjitale, të cilat, pasi vulojnë me vulën kohore nga sekretaria përkatëse, kalojnë në arkivin e digjitalizuar.”

## Neni 16

Pika 2, e nenit 41, ndryshohet si më poshtë:

“2. Organet që propozojnë dhe miratojnë aktet ligjore dhe nënligjore, të cilat rregullojnë çështjet e lidhura me dokumentin elektronik, duhet të marrin mendimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave përpara miratimit të aktit.”

## Neni 17

Neni 42 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 42

Dokumentet arkivore, me mbarimin e afatit të shërbimit operativ, pranë arkivave të institucioneve fondkrijuese ose arkivave qendrorë në veprim, sipas këtij ligji, dorëzohen prej tyre për ruajtje dhe administrim në arkivat përkatës të përhershëm, të përpunuara dhe të inventarizuara sipas rregullave të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.”.

## Neni 18

Neni 43 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 43

1. Dorëzimi i dokumenteve të autoriteteve publike në arkivin e përhershëm përkatës, sipas nenit 9 të këtij ligji, bëhet sipas këtyre afateve:

a) dokumentet administrative, tekniko-shkencore dhe në figurë, në zë e në lëvizje dorëzohen jo më herët se 15 vjet dhe jo më vonë se 25 vjet nga viti i krijimit të tyre;

b) regjistrat e akteve të gjendjes civile, amzat shkollore, si dhe çdo dokument tjetër që i nevojitet qytetarit përgjatë të gjithë jetës së tij dhe klasifikohet si dokument me rëndësi historike kombëtare nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, dorëzohen jo më herët se 75 vjet dhe jo më vonë se 120 vjet nga viti i krijimit të tyre. Afati specifik i ruajtjes pranë Arkivit Qendror në Veprim përkatës, përpara dorëzimit në arkivin e përhershëm, përcaktohet në varësi të llojit të dokumentacionit, në vendimin e Këshillit të Ministrave, të miratuar sipas pikës 3, të nenit 24 të këtij ligji;

c) dokumentet e klasifikuara “sekret shtetëror” dorëzohen pas deklasifikimit të plotë nga autoriteti klasifikues përkatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi “Për informacionin e klasifikuar”. Institucionet që kanë në varësi arkiva qendrorë në veprim, për dorëzimin e dokumenteve pas deklasifikimit, zbatojnë afate të cilat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas pikës 3, të nenit 24 të këtij ligji.

2. Këshilli i Lartë i Arkivave vendos afatet për tipologji të tjera, në përputhje me vlerën e tyre operative, të paparashikuara në pikën 1 të këtij neni.

3. Personat juridikë e fizikë privatë, që me legjislacionin specifik të rregullimit të tyre kanë dokumentacion, ruajtja e të cilit është i detyrueshëm për shkak të funksionit publik, të shpallur me rëndësi historike dhe kombëtare nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, dorëzojnë dokumentacionin në përputhje me afatet e përcaktuara me urdhër të përbashkët të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave dhe ministrisë përgjegjëse të fushës së veprimtarisë së tyre.”.

## Neni 19

Në nenin 61, shtohen pikat 3, 4 dhe 5 me këtë përmbajtje:

“3. Dokumentet, që ruhen në bazat e të dhënave shtetërore apo në sistemet e të dhënave shtetërore, shfrytëzohen në përputhje me rregullat e këtij ligji.

4. Dokumentet e krijuara dhe/ose të ngarkuara në sistemin elektronik të projektakteve të Këshillit të Ministrave *e-akte*, që prej fillimit të funksionimit të këtij sistemi, konsiderohen pjesë e dokumentacionit të projektaktit. Ky rregull zbatohet për të gjitha dokumentet që janë ngarkuar në këtë sistem nga organet kompetente, sipas legjislacionit “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, duke përfshirë dokumentet elektronike që përmbajnë nënshkrimin elektronik apo vulën elektronike, dokumentet e tjera në format elektronik që nuk i përmbajnë këto elemente, si dhe dokumentet që ngarkohen si kopje e një dokumenti shkresor *hard copy* të vlefshëm, të krijuar jashtë sistemit.

5. Dokumentet e përcaktuara në pikën 4 të këtij neni, në rast nevojë të arkivimit dhe/ose shpërndarjes e shfrytëzimit në format shkresor *hard copy* nga të tretë, pas printimit shoqërohen me vulën e institucionit ose me elemente të tjera teknologjike të autentifikimit, si: barcode, kode QR etj.”.

Neni 20

Nenet 63, 65, 66, 67, 71 dhe 72 shfuqizohen.

Neni 21

Neni 82 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 82

Leja për paraqitjen e dokumenteve të Fondit Arkivor Kombëtar në mjedise ndërkombëtare jepet nga Këshilli i Ministrave pas mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave.”.

Neni 22

Neni 89 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 89

1. Punonjësi i rrjetit arkivor të Republikës së Shqipërisë respekton Kodin Deontologjik Ndërkombëtar të Arkivistëve.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, vetë ose në bashkëpunim me institucione të arsimit të lartë dhe/ose autoritetin përgjegjës për trajnimin dhe kualifikimin e nëpunësve të autoriteteve publike, zhvillon trajnime dhe/ose praktika arkivore, të thelluara ose afatshkurtra, i pajis me dëshmi nëpunësit e rrjetit arkivor dhe individë të tjerë që kërkojnë të punësohen në rrjetin arkivor.”.

Neni 23

Në nenin 93, shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Dokumentet e klasifikuara “Sekret shtetëror”, që ndodhen në arkivat e përhershëm, jepen për njohje dhe shfrytëzim ose mund të kufizohet dhënia e tyre sipas kërkesave të legjislacionit për informacionin e klasifikuar deri në deklasifikimin e tyre të plotë.”.

Neni 24

Në fund të nenit 94 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Ngarkohen institucionet përgjegjëse për çështjet e administratës publike dhe për buxhetin që të përgatisin ndryshimet e nevojshme në strukturën/organikën dhe buxhetin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave dhe të ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme, në përputhje me riorganizimin e parashikuar në dispozitat e këtij ligji.”.

Neni 25

Në të gjithë tekstin e ligjit bëhen këto ndryshime në terma, shprehje dhe referenca:

a) fjalët “i/e/të numerizuar/a” zëvendësohen me fjalën “elektronik/e/ë”;

b) emërtimet “Fondi Arkivor Kombëtar” dhe “Rrjeti Arkivor Kombëtar” zëvendësohen përkatësisht me emërtimet “Fondi Arkivor i Republikës së Shqipërisë” dhe “Rrjeti Arkivor i Republikës së Shqipërisë”;

c) kudo ku referohet neni 9 i ligjit dhe janë përmendur shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh” dhe “e” të tij, këto shkronja hiqen dhe referenca mbetet vetëm në nenin 9.

#### Neni 26

### **Ndryshime në ligje të tjera**

Në ligjin nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, neni 18/4 riformulohet si më poshtë:

“Arkivi Shtetëror Qendror i Drejtësisë është arkiv tipologjik që organizohet dhe funksionon pranë Ministrisë së Drejtësisë. Rregullat e funksionimit dhe organizimit të Arkivit Shtetëror Qendror të Drejtësisë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për arkivat.”.

#### Neni 27

### **Dispozitë kalimtare**

Arkivi i Shërbimit Informativ Shtetëror vijon aktivitetin e tij pa ndryshime deri në miratimin e vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për atributet e arkivit qendror në veprim.

#### Neni 28

Ky ligj shtrin efektet mbi rregullat arkivore në veprimtarinë e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, për aq sa nuk parashikohet ndryshe në ligjin nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

#### Neni 29

### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Përfundimisht kalimi i arkivave të sistemit të Punëve të Brendshme dhe të Forcave të Armatosura në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave hyn në fuqi në datën 1 janar 2025.

Miratuar në datën 4.4.2024.

**Shpallur me dekretin nr. 157, datë 23.4.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.**